




REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
Kuvendi Komunal – Skupština Opštine – Municipal Assambly
JUNIK



Rregullorja Komunale nr.6/2009

RREGULLORE

**PËR REKLAMIMIN DHE SHITJEN E MALLRAVE DHE ARTIKUJVE
TË TJERË JASHTË LOKALIT AFARIST**

Junik
Korrik , 2009

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Statutit të Komunës së Junikut neni 20 dhe 53. Kuvendi Komunal Junik, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 28.07.2009, miratohet këtë:

RREGULLORE

PËR REKLAMIMIN DHE SHITJEN E MALLRAVE DHE ARTIKUJVE TË TJERË JASHTË LOKALIT AFARIST

Neni 1

1.1. Për reklamimin dhe shitjen e mallrave dhe artikujve të tjerë jashtë shitoreve, vetëshërbimeve, kafeneve dhe restoranteve në vendet publike, të interesuarit duhet të parashtrijnë kërkesë Drejtorisë për Planifikim, Urbanizëm, Gjeodezi, Kadastër dhe Mjedis për dhënien e pëlqimit.

1.2. Drejtoria për Buxhet dhe Financa lëshon LEJEN, pas dhënies së pëlqimit parashtruesit të kërkesës nga Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm, Gjeodezi, Kadastër dhe Mjedis.

1.3. Për marrjen e Lejes, parashtruesi i kërkesës, duhet t'i paguaj 20 €.

Neni 2

Pronarët e shitoreve, vetëshërbimeve, kafeneve dhe restoranteve në vendet publike të cilët janë të interesuar për reklamimin dhe shitjen e mallrave dhe artikujve të tjerë para lokaleve të tyre, duhet gjithashtu të kërkojnë leje në Drejtorinë për Planifikim, Urbanizëm, Gjeodezi, Kadastër dhe Mjedis, për shfrytëzim të hapësirave publike.

2.1. Shfrytëzimi i hapësirave publike për shitje të mallrave para objekteve tregtare do të paguhet në një shumë mujore sipas zonave në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

- Zona e I 2,00 €/m² në muaj
- Zona e II 1,00 €/m² "
- Zona e III 0,50 €/m² "
- Zona e IV 0,25 €/m² "

2.2. Kurse për shfrytëzim të hapësirës publike, ekspozimi (reklamimi) i mallit dhe ambalazhit do të paguhet *tarifa vjetore* sipas zonave:

- Zona e I 10,00 €/m²
- Zona e II 8,00 €/m²
- Zona e III 5,00 €/m²
- Zona e IV 3,00 €/m²

Neni 3

Ndalohet shfrytëzimi i trotuareve për ushtrimin e aktiviteteve tregtare dhe shërbyese.

Neni 4

Ndalohet shitja dhe reklamimi i mallrave në vendet publike në Komunën e Junikut, nëse me këtë pengohet qarkullimi i lirë i njerëzve dhe automjeteve.

Neni 5

Ndalohet reklamimi dhe ekspozimi i artikujve ushqimor që prishen lehtë, siç janë: mishi dhe produktet e mishit, qumështi dhe produktet e qumështit dhe gjërat tjera ushqimore të cilat nuk bënë të reklamohen dhe ekspozohen në dritë dhe diell jashtë lokaleve në vendet publike.

Neni 6

Të gjithë personat juridik dhe fizik të cilët kryejnë aktivitete në kundërshtim me këtë Rregullore, për mosrespektim dhe mos përmbushjen e kushteve të parapara, do të dënohen me gjobë në të holla, si vijon:

- a) Për mos posedim të Lejes për shfrytëzim të sipërfaqeve para lokaleve afariste, të përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 1 dhe të nenit 2 të kësaj Rregullore, do të dënohen me gjobë në lartësi prej: 50 – 150 €,
- b) Të gjithë personat fizik dhe juridik të cilët i shfrytëzojnë trotualet për ushtrimin e aktiviteteve tregtare dhe shërbyese të ndaluar me nenin 3. të kësaj Rregullore, do të dënohen me gjobë në lartësi prej: 50€,
- c) Për mosrespektim të nenit 4, të kësaj Rregullore, parashihet dënimi me gjobë prej: 50-150 €,
- d) Për veprim në kundërshtim me nenin 5, të kësaj Rregullore, parashihen dënime me gjobë në lartësi prej: 50-150€.

Neni 7

7.1. Përgjegjës për zbatimin e kësaj Rregullore është Drejtoria për shërbime publike dhe Inspektion komunal.

7.2. Për mos mundësin e zbatimit të kësaj Rregullore në teren, Inspektori përkatës, e fton me shkresë, Policin e Kosovës për mbështetje në zbatimin e Rregullores.

Neni 8

Kjo Rregullore hynë në fuqi menjëherë pas miratimit në Kuvendin Komunal dhe nënshkrimit nga ana e Kryesueses së Kuvendit.

KUVENDI KOMUNAL JUNIK

Datë: 28.07.2009

Nr: _____

**Kryesuesja e Kuvendit Komunal
Zelfishahe Shala**